



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 14.04.2017

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “MBILARTËSIM I PORTAVE
TË DIGËS DHE RIKONSTRUKSIONI PAJISJEVE TË HEC ULZA”, ME
VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ULËZ, BASHKIA MAT**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Kurum International” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Mbilartësim i portave të digës dhe rikonstruksioni pajisjeve të HEC Ulza”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Ulëz, Bashkia Mat, me subjekt zhvillues “Kurum International” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Mat.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI I KKT

EDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISE SE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

